



BASHKIA SHKODËR

Nr. 2019 Prot, datë 07/02/2019



IDEA INSTITUTE

Nr. 3 Prot, datë 07/02/2019

MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

Sot në Shkodër me datë/...../2019, duke u mbështetur në vullnetin e lirë të palëve, lidhet kjo Marrëveshje Bashkëpunimi ndërmjet:

Bashkisë Shkodër me seli ligjore Rr. "13 Dhjetori", Shkodër, përfaqësuar nga Znj. Voltana ADEMI në cilësinë e titullarit të Institucionit,

dhe

IDEA INSTITUTE me nr. NIPTI L82417002V, "Rr. Ali Demi, P 257/1, Tiranë," përfaqësuar nga Z. Sadedin Limani, në cilësinë e Drejtorit dhe të Themeluesit

BAZA LIGJORE:

Ligji nr 139/2015 "Për vetqeverisjen Vendore"

Neni 1

Qellimi i marrëveshjes

1. Kjo marrëveshje ka për qellim:
 - a) Të kontribuojë në nxitjen dhe përmirësimin e zhvillimit ekonomik, nëpërmjet projekteve dhe tërheqjes së investimeve të huaja për realizimin e tyre.
 - b) Të realizojë krijimin e partneritetit vendas dhe të huaj me qëllim mbështetjen projekteve për zhvillim, infrastrukturë rurale dhe urbane dhe të biznesit.
 - c) Të ofrojë asistencë teknike dhe shërbime të konsulencës për projekte për zhvillim, për mbështetjen dhe nxitjen e biznesit, projekte në infrastrukturën urbane dhe rurale, studime në fusha të ndryshme të ekonomisë dhe të biznesit.

Neni 2

Objekti i marrëveshjes

Bashkëpunim me qëllim ofrimin e shërbimeve në mbështetje të zhvillimit social-ekonomik vendor dhe identifikimin e mundësive të reja për zhvillimin e biznesit duke pasur në fokus shrytëzimin racional dhe inovativ të potencialeve ekonomike, natyrore dhe njerëzore që disponon Bashkia Shkodër në tërë shtrirjen territoriale të saj si edhe në hapësirat rajonale e ndërrajonale në të cilat ajo bën pjesë.

SADEDIN LIMANI
IDEA
NUTS: L 82417002V

Neni 3



Fushat e bashkëpunimit

Konsulencë teknike, studime dhe projekte për mbrojtjen e mjedisit, zhvillimin ekonomik e social, formimin profesional e shkencor, inovacionin teknik e teknologjik, shkëmbimin, ruajtjen dhe mirëmbajtjen e informacionit, rritjen e sigurisë civile nga fatkeqësitë e ndryshme.

Neni 4

Të drejtat dhe detyrimet e palëve

Të drejtat dhe detyrimet e Bashkisë Shkodër

- a) Të koordinojë dhe monitorojë organizimin e aktiviteteve për zhvillimin e biznesit në shkallë vendore.
- b) Të koordinojë pjesëmarrjen e subjekteve private dhe shtetërore si edhe të shoqatave të ndryshme në aktivitetet që organizohen nga Bashkia Shkodër për zhvillimin e biznesit.
- c) Të promovojë sipas mundësive punën dhe aktivitetin e IDEA INSTITUTE dhe të subjekteve të tjera bashkëpunuese të saj, të vendit dhe të huaja në drejtim të përgatitjes dhe të zbatimit të projekteve dhe të financimit të tyre.
- d) Të njoftojë partnerin/partnerët për çdo vështirësi të identifikuar që ka lidhje me aktivitetin e saj.
- e) Të respektojë nen për nen Akt-marrëveshjen.

Të drejtat dhe detyrimet e IDEA Institute

- a) Të zhvillojë aktivitetin e saj në ofrimin e asistencës teknike dhe zhvillimin ekonomik dhe social të territorit të Bashkisë Shkodër.
- b) Të sigurojë vendosjen e partneritetit vëndas dhe të huaj me qëllim mbështetjen e biznesit, hartimin e projekteve duke u mbështetur në teknologjitë inovative dhe shfrytëzimin e potencialeve natyrore dhe njerëzore të Bashkisë Shkodër.
- c) Të mundësojë tërheqjen e investimeve të huaja dhe krijimin e kompanive me kapital miks.
- d) Të mbështesë Smart Specialisation për një shfrytëzim sa më efektiv të potencialeve natyrore dhe njerëzore për të përfituar realisht nga fondet e Bashkimit Europian për këtë qëllim si edhe ngritjen e kompanive të reja start up dhe zhvillimin e SME-ve ekzistuese, përfshi këtu edhe Francising.
- e) Të ofrojë e të sigurojë metodologji dhe teknologji bashkëkohore në menaxhimin dhe administrimin efektiv të projekteve dhe të investimeve përmes sistemeve të dixhitalizuara të shkëmbimit të informacionit në kohë reale dhe një Baze të Dhënash të qëndrueshme dhe funksionale moderne.
- f) Të ofrojë konsulencë teknike të specializuar, studime fizibiliteti sipas performanës së kërkuar deri në sigurimin e dizajneve teknike të plota zbatuese lidhur me mbrojtjen e mjedisit dhe rritjen e sigurisë civile në fatkeqësitë nga burime natyrore dhe ndërhyrjet abuzive njerëzore.
- g) Të ofrojë në veçanti teknologji moderne, projekte dhe burime potenciale financiare për mbrojtjen e Liqenit të Shkodrës nga shkarkimet e ujërave të zeza dhe urbane dhe rurale në gjithë pellgun ujëmbledhës të këtij liqeni me qëllim mbrojtjen e florës dhe të

SADEDIN LIMANU
IDEA
NUIS: L 82417003



- faunës si edhe uljen e shkallës së ndotjes në Detin Adriatik përmes impianteve efektive dhe smart të përpunimit dhe të neutralizimit të shkarkimeve të dëmshme.
- h) Të bashkëpunojë me Bashkinë Shkodër në rast zhvillimi të aktiviteteve promovionale për teknologji të reja në fushën e mjedisit, infrastrukturës, të informacionit si edhe në fushën e formimit profesional, shkencor dhe intelektual.
- i) Të respektojë nen për nen Akt-marrëveshjen.

Neni 5 Afati i marrëveshjes

Kjo Akt-marrëveshje nënshkruhet nga palët me vullnetin e tyre të lirë dhe të plotë për një afat tre vjeçar me të drejtë rinovimi.

Neni 6 Komunikimi

Çdo komunikim midis palëve do të bëhet me shkrim.

Neni 7 Njoftimet

Çdo njoftim, kërkesë apo çdo lloj komunikimi ndërmjet palëve do të bëhet sipas mënyrës së përcaktuar në Akt-marrëveshje, njoftimi i palëve do të bëhet me shkrim brenda 15 ditëve nga marrja dijeni e faktit dhe të problemeve që mund të lindin gjatë ekzekutimit të kësaj Akt-marrëveshje.

Neni 8 Zgjidhja e mosmarrëveshjes

Asnjëra nga palët nuk ka të drejtë të zgjidhë Akt-marrëveshjen në mënyrë të njëanshme pa shkaqe të arsyeshme dhe para se të kenë njoftuar njera-tjetrën me shkrim të paktën 30 ditë përpara.

Palët bien dakord që çdo mosmarrëveshje apo kontraditë do të përqipen t'i zgjidhin me mirëkuptim. Nëse palët dështojnë në zgjidhjen e mosmarrëveshjes ose konfliktit ato i drejtohen zgjidhjes së Akt-marrëveshjes duke respektuar procedurat juridike sipas legjislacionit të Republikës së Shqipërisë.

Neni 9 Dispozita të fundit

Kjo Akt-marrëveshje do të quhet e vlefshme duke filluar nga data e nënshkrimit të saj nga palët. Kjo Akt-marrëveshje u hartua në 3 kopje nga të cilat një të merr IDEA Institute ndërsa dy të tjerat i mban Bashkia Shkodër.

Për Bashkinë Shkodër

Kryetari

Voltana Ademi



Për IDEA INSTITUTE

Drejtori

Sadedin Limani



Konceptoi: S. Mardushe
Miratoi: R. Sakshi